



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2023

VENDIM

Nr. 530, datë 11.10.2023

PËR

PËR TRANSFERIMIN E PËRKOHSHËM TË GJYQTARIT

Z. {...} NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË TIRANË

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit” i ndryshuar, në vendimin Nr. 514 datë 05.10.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe duke mbajtur në konsideratë dhënien e pëlqimit të gjyqtarit {...} me shkresën nr. 5156 prot., datë 06.10.2023, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Transferimin e përkohshëm me pëlqim të gjyqtarit z. {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin.
2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 16.10.2023.
3. Gjyqtari z. {...} përjashtohet menjëherë nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në gjykatën ku ka caktimin e përhershëm, Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.
4. Gjyqtari z. {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet gjyqësore që ka në gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, që ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare, si dhe gjykimin e çështjeve të veçanta, në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, të caktuara me vendim të Këshillit. Çështjet e tjera gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë dorëzohen menjëherë prej tij.
5. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

6. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR